



Projekti Shëndet për të Gjithë

Rezultatet e fazës së parë



Të dhëna kyce për HAP-1



Kohështrirja
Janar 2015 -
Mars 2019




Donator:

Qeveria e Zvicrës përmes
Agjencisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim




Rajonet e mbuluara:
Qarku Diber dhe
Qarku Fier

Konsorciumi zbatues: Instituti
Zviceran i Shëndetit Publik dhe
Mjekësisë Tropikale (udhëheqës);
Terre des Hommes; Save the Children;
Qendra HAP



Swiss TPH



Objektivi i përgjithshëm: HAP synon të mundësojë shëndet më të mirë për popullatën shqiptare, falë shërbimeve të përmirësuara të kujdesit shëndetësor parësor dhe aktiviteteve të promocionit shëndetësor. Rezultatet specifike të HAP-it fokusohen: (1) në institucionet e sektorit shëndetësor dhe (2) te qytetarët:



Rezultati 1: Angazhimi i qeverisë donatorëve dhe aktorëve të tjerë përkatës në sistemin shëndetësor do të çojë drejt një menaxhimi dhe ofrimi më të mirë të shërbimeve përmes profesionistëve të kualifikuar të shëndetësisë.



Rezultati 2: Qytetarët në qarqet e synuara kanë më shumë akses në shërbime cilësore të kujdesit shëndetësor. Përmes pjesëmarrjes më të madhe, qytetarët më të vetëdijshëm për shëndetin, kontribuojnë në arritjen e një sistemi shëndetësor më të përgjegjshëm dhe reagues.



Vijimësia: Projekti ka hyrë në fazën e tij të dytë më 1 prill 2019 i zbatuar nga Instituti Zviceran i Shëndetit Publik dhe Mjekësisë Tropikale (Swiss TPH) përmes Qendrës HAP.

Ndikimi i HAP në cilësinë e kujdesit shëndetësor në Shqipëri dhe aksesin në shërbimet shëndetësore

Në vitin 2015 dhe 2018 në qarkun e Dibrës dhe të Fierit janë realizuar dy studime për të matur ndikimin e ndërhyrjeve të HAP, përkatësisht studimi për 'Cilësinë Kujdesit Shëndetësor' dhe 'Aksesi i familjeve në shërbimet e KSHP-së'. Disa prej rezultateve kryesore janë si më poshtë:

Cilësia e shërbimeve të ofruara në nivel KSHP-je ka pësuar ndryshime pozitive në të dy qarqet e projektit ku ka një rritje prej 10% në përdorimin e shërbimeve të KSHP-së sikurse rezultojnë nga studimi i kryer në 38 qendra të KSHP-së në zona urbane dhe rurale në Fier dhe Dibër.

Cilësia e ofrimit të shërbimit shëndetësor është përmirësuar me 20-30%, çka do të thotë që mjekët e familjes po ndjekin më mirë procedurat dhe protokollet standarde për vlerësimin klinik dhe fizik të pacientëve diabetikë dhe atyre me hipertension dhe si rezultat, është përmirësuar kujdesi për pacientët me sëmundje kronike jo-infektive.

Mjekët flasin më gjatë me pacientët diabetikë lidhur me:

- përshtatjen me mjekimin (77% kundrejt 62% në 2015),
- rëndësinë e kryerjes së aktivitetit fizik (42.6% kundrejt 5% në 2015),
- nevojën për vizita pasuese (72% kundrejt 47% në 2015)
- informacion mbi mjekimin e dhënë (78% kundrejt 47% në 2015)
- dhënien e rezultateve të analizave (67% kundrejt 42% në 2015).

Situata duket premtuese edhe për pacientët me hipertension ku mesatarja e përmirësimit të cilësisë për ta rritet nga 40% në 60%. Rritja e cilësisë së shërbimit për pacientët me hipertension reflektohet më së shumti në:

- dhënien e këshillave (nga 38% në 60%)
- mundësinë e pacientit për të bërë pyetje (nga 24% në 46%).

Infrastruktura e shërbimeve të KSHP është përmirësuar ndjeshëm lidhur me çështje të higjienës, ruajtjen dhe zhvendosjen e mbetjeve spitalore, disponueshmërinë e pajisjeve bazë mjekësore, transparencën dhe përgjegjshmërinë publike. Rritja e cilësisë së infrastrukturës vlerësohet të jetë 17% më e mirë në qarkun Dibër dhe 6% më e mirë në qarkun Fier krahasuar me vitin 2015.

Kënaqësia e pacientëve në të dy qarqet vijon të jetë e lartë lidhur me shërbimin shëndetësor në nivel KSHP-je ku 89-95% e pacientëve pohojnë se janë të kënaqur ose shumë të kënaqur me shërbimet e KSHP-së.

Në përgjithësi Shqipëria ka pasur një ecuri pozitive lidhur me aksesin e shërbimeve të KSHP-së sikurse rezultojnë nga anketimi "Aksesi i familjeve ndaj shërbimit shëndetësor parësor":

■ 80% e pacientëve kronikë dhe 87% e pacientëve akutë pohojnë se nuk kanë hasur vështirësi në marrjen e shërbimit shëndetësor (2015: 70% e pacientëve kronikë dhe 76% e pacientëve akutë).

■ Shërbimi shëndetësor për nënën dhe fëmijën është përmirësuar: 69% e nënave pohojnë se janë vizituar nga personel mjekësor pas daljes nga spitali

■ Është përmirësuar njohuria mbi sëmundjet kardio-vaskulare ku 23% e të intervistuarve kanë listuar më shumë se katër faktorë rrishtës të kësaj sëmundjeje (2015: 18%)

Mbështetje për hartimin e politikave dhe strategjive në nivel kombëtar

Ndërveprimi i SDC/HAP dhe donatorëve të tjerë me MSHMS ka rritur ndjeshmërinë dhe ndërgjegjësimin e vendim-marrësve lidhur me nevojën për reformën në KSHP dhe promocionin shëndetësor. Si rrjedhojë, janë zhvilluar dhe janë në zbatim një sërë politikash, dokumentash strategjikë dhe plane kombëtare:

1. Studimi Demografik dhe Shëndetësor në Shqipëri u aplikua dhe realizua përgjatë 2017-18. Raporti i këtij studimi shërben si bazë dhe referencë për hartimin e politikave të bazuara në evidenca dhe shërbimeve respektive në përgjigje të nevojave. Studimi u mbështet nga SDC/HAP dhe agjencitë e Kombeve të Bashkuara (UNFPA, UNICEF, UN Women)

2. Plan i Kombëtar i Promocionit Shëndetësor 2017-2021: HAP kontribuoi në hartimin dhe shpërndarjen e këtij dokumenti udhëzues për punën e 12 qarqeve në Shqipëri lidhur me promocionin e shëndetit në popullatën shqiptare.

3. Strategjia Kombëtare e KSHP - HAP është angazhuar në mbështetjen teknike të procesit të hartimit të Strategjisë së Parë në KSHP të iniciuar nga MSHMS përmes mobilizimit të ekspertëve të huaj dhe kombëtarë.

4. Anketime dhe studime- studimi mbi "Cilësinë e Shërbimit në KSHP" (në 2015 dhe 2018); "Aksesi i familjeve në shërbimet e KSHP-së" (në 2015 dhe 2018) dhe "Vulnerabiliteti Shëndetësor në KSHP"


5. Zhvillimi i dokumentave rregullatore - HAP ka mbështetur zhvillimin e disa dokumenteve që lehtësojnë punën në KSHPsi: a) Udhëzuesi për buxhetimin e QSH-ve; b) Paketa e dokumentave të nevojshëm për akreditimin e qendrave shëndetësore të KSHP; c) Udhëzuesi për funksionimin e Grupeve të Kolegjeve.



Mbështetje për forcimin e kapaciteteve menaxheriale në shëndetësi

Program i ri Master në Menaxhim Shëndetësor

Hapja dhe funksionimi i Programit të Masterit në Menaxhim Shëndetësor është një mundësi për formimin e kapaciteteve menaxheriale shëndetësore në Shqipëri. Programi ofrohet për herë të parë në Shqipëri si rezultat i bashkëpunimit të fakulteteve të dy universiteteve të ndryshme, përkatësisht nga Fakulteti i Mjekësisë (Universiteti i Mjekësisë) dhe Fakulteti i Ekonomisë (Universiteti i Tiranës). Kohorta e parë e studentëve është diplomuar në vjeshtën e vitit 2018 dhe kohorta e dytë filloi studimet në nëntor 2018.



Përmirësimi i kapaciteteve të ekipeve menaxheriale të qendrave të kujdesit shëndetësor parësor dhe përtej.

Duke qenë të bindur se burimet njerëzore të kualifikuara dhe të afta janë të një rëndësie kyçe për përmirësimin e shërbimit në KSHP, HAP ka mundësuar disa trajnime mbi menaxhimin.

Rezultatet e këtyre trajnimeve janë optimizuar përmes Forumit të Menaxherëve, një mjet i Edukimit të Vazhdueshëm i prezantuar dhe mbështetur nga HAP dhe i njohur e akredituar nga QKEV për ndarjen e eksperiencave lidhur me aspekte të ndryshme të menaxhimit të QSH-ve. 75% e menaxherëve të QSH-ve në të dy qarqet eHAP-it kanë marrë pjesë në 7 Forume Menaxherësh të akredituar me një numër total prej 130 kreditesh.

Ekipet menaxheriale

Hartimi, zbatimi dhe monitorimi i Planeve Vjetore nga ekipet menaxheriale të 24 QSH-ve në vijim të trajnimeve të kombinuara me sesione mbështetëse.



Menaxherët e QSH-ve

Rritja e kapaciteteve të 80 menaxhërëve të QSH me të cilat HAP punon mbi legjislacionin shqiptar, buxhetimin, menaxhimin e burimeve njerëzore, lidershipin & komunikimin, kontrollin e cilësisë etj.



Kryeinfermieret

97 kryeinfermiere nga të dy qarqet janë trajnuar në lidhje me planifikimin, menaxhimin e burimeve njerëzore, komunikimin, lidershipin dhe organizimin e shërbimit infermior.



Ekonomistët

HAP ka zhvilluar dhe mundësuar seanca trajnimi për 44 ekonomistë të QSH-ve lidhur me buxhetimin dhe planifikimin, legjislacionin, prokurimin, zbatimin e buxhetit etj



Drejtuesit e spitaleve

40 menaxherë spitalësh dhe bashkëpunëtorët e tyre të ngushtë ndoqën kursin 10 ditor 'Hyrje në menaxhimin spitalor' në përgjigje të kërkesës së MSHMS.



80 ekspertë shqiptarë dhe ofrues të shërbimit shëndetësor parësor kanë zhvilluar vizita studimore jashtë vendit me qëllim ndarjen e përvojave dhe mësimin nga eksperiencat më të mira lidhur me organizimin dhe funksionimin e shërbimeve të KSHP-së.

Mbështetje për përmirësimin e aftësive klinike të ekipeve të KSHP-së

HAP ka investuar vazhdimisht në forcimin e kapaciteteve teknike të ofruesve të KSHP-së përmes aktiviteteve të Edukimit të Vazhdueshëm Mjekësor me synim përmirësimin e cilësisë së KSHP-së dhe treguesit shëndetësorë të popullatës.

- Grupet e Kolegëve (GK) janë prezantuar nga HAP si një mjet novator i Edukimit të Vazhdueshëm Mjekësor (EVM) tek ofruesit e KSHP-së në qarkun e Dibrës dhe Fierit. GK janë një mënyrë trajnimi në vendin e punës nëpërmjet të cilit, mjekë familje dhe infermierë të së njëjtës qendër shëndetësore, por jo vetëm, takohen sipas një plani të paracaktuar për të diskutuar mbi çështje të ndryshme të praktikës së tyre klinike. GK janë njohur dhe akredituar nga Qendra Kombëtare e Edukimit të Vazhdueshëm.
- Aktivitetet e EVM-së të mbështetura nga HAP kanë cuar në përmirësimin e praktikës klinike të ekipeve të KSHP-së sikurse rezultoi në anketimin përfundimtar për Cilësinë e Kujdesit. Në të dy rajonet ka një përmirësim prej 20% për mënyrën se si mjekët e përgjithshëm ofrojnë këshillim për pacientët me diabet dhe një përmirësim prej 22% lidhur me këshillimin për pacientët me hipertension.

Përfshirja e ekipeve të KSHP-së në Grupet e Kolegëve

Mjekë të përgjithshëm

71%



Infermierë familje

79%



- 887 infermiere (nga 1181 në total) janë trajnuar mbi përdorimin e mjeteve të cantës së infermieres dhe thuajse të gjitha ekipet e mjekëve dhe infermierëve përgjegjës për shëndetin e fëmijës në 80 QSH-të e qarkut të Dibrës dhe Fierit janë trajnuar për praktikën e vlerësimit të rritjes së fëmijës sipas kurbave të rritjes së OBSH-së dhe raportimin e duhur të praktikave të ushqyerjes së fëmijës dhe treguesve të rritjes.

- Me mbështetjen e HAP, janë zhvilluar dhe shpërndarë në të gjithë QSH-të materiale trajnuese si 'Manuali për përdorimin e mjeteve të cantës së mjekëve' dhe 'Manuali për përdorimin e mjeteve të cantës së infermieres'. Këto manuale kanë ndihmuar mjekët dhe infermieret e KSHP-së së dy qarqeve në zbatimin në praktikën e përditshme të aftësive klinike të fituara gjatë trajnimeve si dhe kanë nxitur trajnimin e mëtejshëm midis kolegëve në nivelin e QSH-së

75 anëtarë të 5 qendrave shëndetësore 24 orëshe kanë ndjekur trajnimin 13-ditor për mjekësinë e urgjencave paraspitalore.

Përmirësimi i infrastrukturës shëndetësore të KSHP dhe pajisjeve mjekësore

Një kontribut i rëndësishëm i HAP gjatë fazës së parë ka qenë investimi direkt në përmirësimin e infrastrukturës së KSHP-së dhe blerjen e instrumentave të nevojshëm mjekësorë për praktikën e përditshme klinike.

Këto investime kanë kontribuar në krijimin e komoditeve për pacientët dhe ka përmirësuar cilësinë e shërbimit por gjithashtu kanë ndikuar në motivimin dhe vetë-besimin e ekipeve të QSH-ve:


316, 150 banorë kanë përfituar shërbimmë të mirë shëndetësor në sajë të investimit prej 3.3 Milionë Euro të SDC për rehabilitimin e 17 QSH-ve (5 në qarkun Dibër; 10 në qarkun Fier dhe 2 në qarkun Tiranë) dhe një poliklinike specialitetesh (Lushnjë).

223 mjekë familje janë pajisur me çantën e mjekut dhe janë trajnuar për përdorimin e 17 instrumentave mjekësorë që përmban çanta

1181 infermiere familje janë pajisur me çantën e infermieres dhe janë trajnuar për përdorimin e 16 instrumentave mjekësorë që përmban çanta

224 mjekë familje në të dy qarqet po përdorin sistemin e lëshimit të recetave elektronike përmes laptopëve të siguruar nga HAP

Të gjithë qendrat e KSHP-së në qarkun Dibër dhe Fier janë pajisur me **233 peshore dhe 330 sisteme matjeje** të gjatësisë/peshës për foshnjat dhe fëmijët duke kontribuar në këtë mënyrë në përmirësimin e monitorimit të rritjes së fëmijëve 0-5 vjeç.



Krahas QSH-ve të rikonstruktura në qarkun Fier dhe Dibër, HAP ka investuar në rikonstruksionin e 2 QSH-ve në qarkun e Tiranës.

Forcimi i qeverisjes së mirë dhe përgjegjshmërisë në qendrat e KSHP-së

Duke konsideruar rëndësinë e madhe që ka transparenca dhe përgjegjshmëria në ofrimin e një shërbimi cilësor, HAP ka ofruar mbështetje teknike dhe financiare për përf forcimin e sistemeve shëndetësore transparente dhe të përgjegjshme:

- HAP bëri funksionale njësitë e anti-korrupsionit në Drejtoritë e Shëndetit Publik (të njohura tashmë si Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor) përmes një sërë trajnimesh për ngritjen e kapaciteteve të tyre lidhur me zbatimin e detyrave dhe roleve të përcaktuara nga MSHMS.

Gjithashtu, HAP pajisi të 80 QSH-të në qarkun Dibër dhe Fier me këndet antikorruption.

- HAP ka mbështetur QSH-të në zhvillimin e mbledhjeve vjetore me pjesëmarrjen e komunitetit, pushtetit vendor, OJF lokale dhe grupe të tjerë interesi. Në këto takime, anëtarët e komunitetit janë informuar mbi performancën e QSH-së përkatëse dhe aktivitetet e planifikuara dhe kanë mundur të flasin për problematikat kryesore që i shqetësojnë. Nga ana tjetër, këto takime kanë ndihmuar menaxherët e QSH-ve që të marrin në konsideratë kërkesat e anëtarëve të komunitetit dhe të punojnë për zgjidhjen e tyre.

- HAP bashkëpunoi me organizata me eksperiencë për zhvillimin e sesioneve informuese për të drejtat e pacientëve/konsumatorëve, antikorruptionin dhe mekanizmat për raportimin e ankesave.



Transparenca dhe përgjegjshmëria në veprim:

1529 ankesa të raportuara
44.8% janë adresuar nga institucionet vendore

2700 anëtarë komuniteti morën pjesë në 92 mbledhje vjetore për performancën e QSH-së

6465 anëtarë komuniteti morën pjesë në 182 sesione informuese

Ndërgjegjësimi publik për sëmundjet kronike jo-infektive

Sëmundjet kronike jo-infektive (sëmundjet kardiovaskulare, diabeti, kanceri, sëmundjet kronike të frymëmarrjes) janë vrasarët më të mëdhenj në Shqipëri dhe shkaqet kryesore të paaftësive.

Gjatë fazës së parë të HAP, rreth 22,000 anëtarë komuniteti kanë qenë përfitues direkt të aktiviteteve të Promocionit Shëndetësor dhe 900 ofrues të KSHP-së janë trajnuar për promocionin shëndetësor me pjesëmarrje me fokus kryesor parandalimin e sëmundjeve kronike jo-infektive:

- Rreth 900 ofrues të KSHP-së nga qarku i Fierit, Dibrës dhe rajone të tjera si dhe specialistë të promocionit shëndetësor që punojnë në 6 Kabinetet e Drejtorive të Shëndetit Publik (tashmë të quajtura Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor) morën pjesë në trajnimet për promocionin shëndetësor me pjesëmarrje. Fokusi i trajnimeve ishte planifikimi, zbatimi dhe monitorimi i aktiviteteve të promocionit shëndetësor.
- HAP mobilizoi dhe mbështeti OJF-të në zbatimin e aktiviteteve të promocionit shëndetësor në shkolla ku morën pjesë 1680 persona (nxënës, mësues dhe prindër). Aktivitetet konsistojnë në promovimin e ushqyerjes së shëndetshme, aktivitetit fizik dhe shëndetit mendor.
- Trajnimet cuan në zhvillimin e disa aktiviteteve të promocionit shëndetësor të cilat u planifikuan dhe zbatuan në bashkëpunim me Institutin e Shëndetit Publik, Kabinetet e Promocionit Shëndetësor të Qarkut Dibrë dhe Fier dhe Qendrat Shëndetësore vendore. Rreth 16,000 anëtarë komuniteti morën pjesë në këto aktivitete ku u informuan mbi parandalimin dhe kontrollin e Diabetit të tipit 2, parandalimin e kancerit të qafës së mitrës dhe parandalimin e kancerit të gjirit, parandalimin dhe kontrollin e hipertensionit, kontrollin më të mirë të talasemisë dhe higjienë personale dhe familjare në familjet rome.
- HAP mbështeti krijimin e 4 spoteve televizive të cilat promovojnë parandalimin e hipertensionit dhe diabetit, kontrollin vjetor mjekësor bazë dhe rolin e mjekut të familjes. Spotet u transmetuan në mediat vendore dhe kombëtare dhe arritën 213,300 shikues.



Fushata PërSHENDETje si një qasje novatore e promocionit shëndetësor

HAP zbatoi një qasje të re për promocionin shëndetësor të quajtur “Fushata PërSHENDETje” me qëllim: 1) Forcimin e njohurive shëndetësore të pjesëtarëve të komunitetit lidhur me sëmundjet jo-infektive; 2) Angazhimin dhe forcimin e profesionistëve shëndetësorë në QSH për të drejtuar dhe mbështetur komunitetet në uljen e rreziqeve lidhur me sëmundjet jo-infektive.

Modeli i Fushatës “PërSHENDETje” është një aktivitet i lëvizshëm i promovimit të shëndetit me pjesëmarrje ku grupe njerëzish qarkullojnë në pesë stacione tematike. Në secilin stacion pjesëmarrësit bëjnë një vetë-vlerësim lidhur me stilin e tyre të jetesës (ushqyerjen, aktivitetin fizik, ekspozimin ndaj duhanit dhe konsumimin e alkoolit).



4800 anëtarë komuniteti morën pjesë në 33 ndalesat e fushatës

Stacioni 1

Prezantimi i faktorëve të rrezikut të sëmundjeve kronike jo-infektive dhe i Fushatës “PërSHENDETje”



Stacioni 2

Rreziqet e ekspozimit ndaj tymit të duhanit përfshirë duhan-pirjen pasive



Stacioni 3

Këshilla për konsumimin e moderuar të alkoolit dhe pasojat shëndetësore që sjell abuzimi me alkoolin



Stacioni 4

Pasojat e aktivitetit të pamjaftueshëm fizik dhe këshilla për shpeshimin e tij



Stacioni 5

Rreziqet e dietës ushqimore jo të shëndetshme dhe parandalimi i keq-ushqyerjes



Në përfudim

Takim me personelin e QSH-së lokale për të diskutuar faktorët e riskut bazuar në vetë-vlerësimin e bërë dhe këshillimi i mëtejshëm



 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Ajencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC



Swiss TPH



 Save the Children